



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:111005

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05857813

C.nr.406/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë civile e shkallës së parë në përbërje prej gjyqtarit individual Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen juridiko-civile të paditëseve R. D. nga fsh. K. K. L. dhe R. D. nga fsh. Sh. K. L., të cilat i përfaqëson Egzona Gashi av. nga Lipjani, me autorizim kundër të paditurës Komunës së Lipjanit-Drejtoria Komunale për Shëndetësi, të cilën e përfaqëson Behar Krasniqi av. publike, me autorizim, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.11.06.2024, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, merr këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e precizuar e paditëseve R. D. nga fsh. K. K. L. dhe R. D. nga fsh. Sh. K. L., si e **BAZUAR**, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtorati i Shëndetësisë në Lipjan, që paditëses dhe atë:

a) Paditëses R. D. në emër të kompenzimit për punën në punkte për periudhën prej dt.12.06.2018-10.06.2021 t'ia paguaj 30% të pagës bazë (314.€) shumën prej 94.20-€ në muaj apo shumën e përgjithshme për 36 muaj, shumën prej 3,391.20-€, dhe

b) Paditëses R. D. në emër të kompenzimit për punën në punkte për periudhën prej dt.12.06.2018-10.06.2021 t'ia paguaj 30% të pagës bazë (377.€) shumën prej 113.10-€ në muaj apo shumën e përgjithshme për 36 muaj, shumën prej 4,071.60-€, me kamatë ligjore prej 8% nga data e ushtrimit të padisë dt.07.06.2021 e deri tek pagesa definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën prej 594.20-€, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditëset R. D. nga fsh. K. K. L. dhe R. D. nga fsh. Sh. K. L., në këtë gjykatë përmes të autorizuarës së saj, ka ushtruar padi ndaj të paditurës Komunës së Lipjanit, për shkak të kompenzimit të t'ardhurave personale në emër të punës në punkte.

Në padi ka theksuar se paditësja R. D. sipas kontratës së punës punon në QKMF Lipjan në punktin Kraishtë ndërsa paditësja R. D. sipas kontratës së punës punon në QKMF Lipjan në punktin Shalë dhe në këtë vend punon që nga hyrja në fuqi e KKS-së. Paditësja R. D. punon në punktin në Kraishtë dhe paditësja R. D. punon në punktin Shalë të cilat janë në largësi më tepër se 5 km nga QKMF-ja në Lipjan dhe në bazë të nenit 35.3 të KKS-së i takon shpërblimi deri në 30% të pagës bazë, andaj paditëseve nuk i janë paguar këto të drejta dhe nuk është vërtetuar se e paditura nuk ka mundësi buxhetore për pagesën e këtyre të ardhurave, andaj paditëset i janë drejtuar gjykatës për realizimin e këtyre të drejtave. Në shqyrtimin gjyqësor ka mbetur pranë padisë dhe pretendimeve të parashtruar në padi duke shtuar se dispozitat e kushtëzuara me

mundësi buxhetore të punëdhënësit janë përmbushur ngase sipas Raporteve të auditimit të viti 2018, 2019 dhe 2020 të Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë vërtetohet se e paditura për të gjitha kategoritë ekonomike ka pasur tepricë buxhetore dhe atë për vitin 2018 në shumë prej 1,279.743 euro, bazuar në fq.12-të të raportit, për vitin 2019 ka pasur tepricë në shumë prej 1,276.808 euro, bazuar në fq. 9 të raportit dhe për vitin 2020 ka pasur tepricë në shumë prej 2,218.292.43 euro, bazuar në fq.16-të të raportit të auditimit. Distanca ku ka punuar paditësja R. D. në K. ka prej 8,4 km larg nga QKMF-ja në Lipjan ndërsa paditësja R. D. në Sh. ka prej 25.3 dhe për ta plotësuar këtë kusht duhet të jetë distanca së paku 5 km sipas KKS-së.

Me parashtrësën e dt.10.06.2024 pala paditëse e ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në fjalën përfundimtare e autorizuara e paditëses ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe precizimit të saj, duke shtuar se falën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim e të cilës ia ka bashkangjitur ekspertizën financiare të ekspertit Shaban Sylja i cili në një rast tjetër të natyrës së njëjt ka sqaruar mundësit buxhetore të të paditurës dhe për këtë arsye nuk është e nevojshme të angazhojm ekspert financiar për këtë çështje që të krijojmë shpenzime të pa nevojshme. Ndërsa i kundërshtojmë pretendimet e të paditurës sa i përket mungesës së buxhetit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ngase vetë nga raportet e Auditimit vërtetohet se e paditura për gjatë këtyre viteve ka qenë në suficit edhe në këtë kategori dhe atë për vitin 2018 në shumën 59,179.00 euro, për vitin 2019 shumën 242,677.00 euro dhe për vitin 2020 shumën 30,103.09 euro, ndërsa çështja e planifikimit të buxhetit në kategorinë paga dhe mëditje bëhet përmes planifikimit dhe aprovimit të qarkores së parë buxhetore me Ligjin për ndarjet buxhetore të RKS-së për vitet 2018, 2019 dhe 2020 në të cilën janë të bashkangjitura edhe tabela 3.1 për të gjitha organizatat buxhetore përfshirë edhe Komunitat ku vërtetohet se kategoria paga dhe mëditje buxheti i ndahet në bazë të numrit të të punësuarve, andaj këto pretendime mbështeten Ligjet për ndarjen e buxhetit për vitet kontestuse si dhe në ekspertizën të cilën e kemi bashkangjitur në fjalë përfundimtare, ngase e paditura nuk i ka përfillur procedurat për planifikimin e buxhetit me qëllim të krijimit të mundësive buxhetore për pagesë të pagave të 13 dhe për kompensimin në punkte. Në fjalën me shkrim ka shtuar se nga provat që u administruan në këtë çështje kontestimore, Kontratat e punës, Vërtetimi i lëshuar nga QKMF Lipjan, ekstrakt nga Google Maps për distanconin LIPJAN-KRAISHTË dhe LIPJAN-SHALË dhe shkresa tjera që janë në dosje të lëndës, mjaftueshëm është argumentuar baza ligjore e kërkesëpadisë ngase: Pala paditëse R. D. në bazë të Kontratës së punës është i angazhuar në Puntin-Kraishtë dhe R. D. në bazë të Kontratës së punës është i angazhuar në Puntin-Shalë, të cilat janë më shumë se 5 kilometra larg Qendrës së Mjekësisë Familjare në Lipjan, e bazuar në nenin 35.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë të datës 12.06.2018 të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe FSHK, u takon shpërblimi deri në 30% të pagës bazë. Fakti i mundësive buxhetore për pagesë të pagës së 13-të dhe punës në punkte vërtetohet sipas Raporteve të Auditimit për të paditurën që janë përmendur dhe mbi bazën e këtyre Raporteve rezulton se Komuna e Lipjanit ka pas suficit-tepricë të buxhetit në të gjitha burimet e fondeve dhe në gjitha kategoritë ekonomike, e bazuar në kërkesat e palës paditëse me tepricën buxhetore, e paditura ka qenë e obliguar të ia paguaj kompensoj shtesën në pagë për punën në punkte dhe paga 13-ta ngase ka pas mundësi buxhetore për pagesë. Duke qenë se me dispozitën ligjore të nenit 17 paragrafi 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 parashihet se "Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 (trembëdhjetë) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit", dhe nga interpretimi i kësaj dispozitive ligjore, si dhe Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme me numër, 212/2023, i datës 09.10.2023, lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për kompensimin e kushteve ligjore për shpërblimin e pagës së 13-të, përderisa çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. E sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të lartcekur rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore,

përkatësisht nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit-pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në harrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. Të njëjtin interpretim në mënyrë analoge duhet ta përfillim edhe tek dispozita e nenit 35 par. 3 i KKS me të cilin parashihet se "Punëtorët të cilët punojnë në punkte të cilat janë 5 kilometra larg Qendrave të Mjekësisë Familjare, ju takon kompensimi deri në 30% të pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit apo mënyre tjetër të kompensimit sipas ligjeve në fuqi". Në rastin konkret, e paditura deri më tani nuk ka ofruar asnjë provë për ta mbështetur pretendimin e saj se nuk ka mjete buxhetore për t'ia kompensuar pagës së 13-të dhe kompensimin për punën në punkte, në kuptimin e nenit 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së dhe nenin 322 paragrafi 3 të LPK-së, ku parashihet se "Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër" Po ashtu e paditura nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka përfillur procedurat për planifikim të buxhetit, respektivisht vlerësimin për krijimin e mundësive buxhetore për ndarjen e linjës buxhetore për të drejta dhe benefitet të punëtorëve të parapara me KKS, sipas procedurave për ndarjen e buxhetit para hartimit të qarkores së parë buxhetore sipas nenin 20.4 e 30 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sipas kësaj dispozita e nenit 17 par. 2 dhe nenit 35. par 3 të KKS e dt. 12.06.2018, parasheh detyrimin e të paditurës të përcaktuar me kusht, dhe atë "sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit", e paditura si palë në marrëdhënie kontraktuese ka vepruar në kundërshtim me parimin e ndërgjeshmërisë dhe ndershmërisë, duke mos përfillur procedurat për planifikim të buxhetit, respektivisht duke mos kërkuar ndarjen e linjës buxhetore për të drejta dhe benefite të punëtorëve të parapara me KKS, sipas procedurave për ndarjen e buxhetit para hartimit të qarkores së parë buxhetore sipas nenin 20.4 e 30 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë andaj, mbi bazën e këtyre pretendimeve dhe në bazë të provave të administruara vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj e precizuar me parashitë dorëzuar me dt.10.06.2024, të cilën i propozoj gjykatës ta aprovoj në tërësi të bazuar.

Shpenzimet e procedure i ka kërkuar sipas TA-së dhe atë për përpilimin e padisë, precizimin, një seancë gjyqësore dhe taksën gjyqësore për padi.

Në të përgjigjur në padi në formë të shkruar e paditura e ka kontestuar si të pa bazë ligjore. Ka konsideruar se sipas Ligjit të Punës Nr.03/L 212 i cili rregullon kontestet e punës askund nuk ceket se punëtorëve të shëndetësisë ju takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditësit i mungon baza juridike. Poashtu ka shtuar se KKS-ja ku është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore për një zbatim të tillë sepse është në kundërshtim me Ligjin e Punës dhe dispozitat e KKS-së janë të kushtëzuara me mundësit buxhetore të punëdhënësit e gjithashtu edhe puna në punkte me rritje prej 30% të pagës bazë është e kushtëzuar me mundësi buxhetore, andaj ka propozuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë kundërshtimeve të cilat i kemi theksuar në përgjigje në padi ngase e paditura nuk është nënshkruese të KKS dhe mendoj se Komuna e Lipjanit nuk ka obligim për këtë detyrim ndërsa sa i përket për llogaritjes kemi theksuar se përllogaritja është mirë e saktësuar, andaj i propozojmë gjykatës që në mungesë të bazës juridike këtë kërkesë ta refuzon si të pa bazuar. Në raportet e auditimit e kemi të sqaruar se mjetet e mjaftueshme buxhetore nga kategoria pagat dhe mëditjet ka pasur vetëm në vitin 2019.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje kontestimore gjykata në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave dhe atë me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr.3-227/2017-SH të lidhur në mes paditëses R. D. dhe të paditurës, me shiqimin dhe leximin e kontratës së punës nr.3-139/2012-SH të lidhur në mes paditëses R. D. dhe të paditurës, me shiqimin dhe leximin e vërtetimit të përvojës së punës nr.41/24 të dt.04.06.2024 të paditëses R. D., me shiqimin dhe leximin e vërtetimit të përvojës së punës nr.83/24 të dt.16.05.2024 të

paditëses R. D., me shiqimin dhe leximin e Raportit të Auditimit për vitin 2018, 2019 dhe 2020 lidhur me të hyrat dhe gjendjen financiare të të paditure, me shiqimin dhe leximin e hartës së destinacionit Lipjan-Kraishtë dhe Lipjan-Shalë të google maps, e të cilat prova gjykata i administroj dhe i vlerësoj në pajtim me nenin 8 të LPK-së, ku vërtetoi këtë gjendje faktike:

a) Paditësja R. D. nga fsh. K. është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga dt.21.06.1999 e tutje në kohë të pa caktuar si pastruse në QKMF në Lipjan në punktin në Kraishtë. Paditësja gjatë kësaj periudhe kontestuse respektivisht gjatë periudhës kontestuse pra nga dt.12.06.2018-10.06.2021 nuk është paguar me shtesën e pagës bazë prej 30% që i bie në shumë prej 94.20 euro për muaj, pasi ka punuar në punktin në Kraishtë në një distancë që është mbi 5 km nga QKMF-Lipjan e që kjo shumë për periudhën në fjalë është në lartësi prej 3,391.20 euro. Mundësit buxhetore të të paditurës për ti përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë në Kosovë e dt.12.06.2018 janë të mundura apo kanë qenë të mundura për periudhën kontestuse.

b) Paditësja R. D. nga fsh. Sh. është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga dt.01.12.2008 e tutje në kohë të pa caktuar si pastruse në QKMF në Lipjan në punktin në Shalë. Paditësja gjatë kësaj periudhe kontestuse respektivisht gjatë periudhës kontestuse pra nga dt.12.06.2018-10.06.2021 nuk është paguar me shtesën e pagës bazë prej 30% që i bie në shumë prej 113.10 euro për muaj, pasi ka punuar në punktin në Shalë në një distancë që është mbi 5 km nga QKMF-Lipjan e që kjo shumë për periudhën në fjalë është në lartësi prej 4,071.60 euro. Mundësit buxhetore të të paditurës për ti përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë në Kosovë e dt.12.06.2018 janë të mundura apo kanë qenë të mundura për periudhën kontestuse.

Këto fakte respektivisht faktet nën a). gjykata i vërtetoi nga kontrata e punës nr.3-227/2017-SH e dt.15.01.2017 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës si dhe vërtetimi i përvojës së punës nr.83/24 i dt.10.06.2024. Gjykata këto fakte i vërtetoi nga lartësia e pagës bazë të realizuar nga paditësja, ndërsa distanca nga QKMF- Lipjan e deri në Kraishtë u vërtetua nga Harta e google maps. Ndërsa mundësit buxhetore të të paditurës për ti përmbushur këto detyrime u vërtetuan nga Raporti i Auditimit për vitin 2018 fq.12-të, për vitin 2019 fq.9 dhe për vitin 2020 fq. 16-të.

Këto fakte respektivisht faktet nën b). gjykata i vërtetoi nga kontrata e punës nr.3-139/2012-SH e dt.16.01.2012 e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës si dhe vërtetimi i përvojës së punës nr.41/24 i dt.10.06.2024. Gjykata këto fakte i vërtetoi nga lartësia e pagës bazë të realizuar nga paditësja, ndërsa distanca nga QKMF- Lipjan e deri në Shalë u vërtetua nga Harta e google maps. Ndërsa mundësit buxhetore të të paditurës për ti përmbushur këto detyrime u vërtetuan nga Raporti i Auditimit për vitin 2018 fq.12-të, për vitin 2019 fq.9 dhe për vitin 2020 fq. 16-të.

Me dispozitën e nenit 35 par.3 parashifet se *“Punëtorët të cilët punojnë në punkte të cilat janë 5 kilometra larg Qendrave të Mjekësisë Familjare, ju takon kompensimi i 30% të pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit apo mënyrë tjetër të kompensimit sipas ligjit”*.

Me dispozitat e nenit 8 të LMD-së, të R. së Kosovës, parashihet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Ndërsa me dispozitën e nenit 245 po të njëjtit Ligj parashihet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegjeje dhe në tërësi në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Pra, bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe dispozitat e lartcekura gjykata vjen në përfundim se e paditura përkundër kërkesës së bërë nga paditëset nuk ia ka paguar shtesën në pagë prej 30% të pagës bazë pasi që paditësja R. D. punon në punktin në Kraishtë ndërsa paditësja R. D. punon në punktin në Shalë që janë në largësi në tepër se 5 km nga QKMF-ja në Lipjan, për periudhën 12.06.2018-10.06.2021, e që arrin lartësinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit dhe meqenëse nga provat veçanërisht nga Raporti i Auditimit për vitet kontestuse shifet se punëdhënësi ka pasur mundësi buxhetore ngase ka pasur tepriçë buxhetore për

periudhat është vërtetuar se e paditura ka pasur mundësi financiare për ti përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale e dt.11.06.2018 andaj gjykata e detyroj të paditurën që paditëses t'ia paguaj shtesën prej 30% të pagës bazë për periudhën kontestuse.

Me rastin e vendosjes gjykata vlerësoj kundërshtimet e të paditurës të theksuara në përgjigje në padi dhe seancën kryesore, mirëpo të njëjtat kundërshtime i refuzoj si të pabazuara me arsyetimin se mundësit buxhetore për ta përmbushur këtë detyrim e paditura kanë ekzistuar siç u tha më lartë dhe kjo është vërtetuar nga Raporti i Auditimit për vitin 2018 fq.12-të, për vitin 2019 fq. 9 dhe për vitin 2020 fq. 16-të, ku Raporti tregon gjendjen financiare të të paditurës që për vitin 2018 ka pasur tepricë buxhetore prej 1,279.743 euro, për vitin 2019 ka pasur tepricë buxhetore prej 1,276.808 euro, dhe për vitin 2020 ka pasur tepricë buxhetore prej 2,218.292.43 euro, andaj këto pretendime sa i përket bazës juridike të padisë gjykata i refuzoj si të pa bazuara, ndërsa kundërshtime tjera lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë nuk ka pasur nga e paditura.

Meqenëse pala paditëse e ka fituar kontestin dhe i ka kërkuar shpenzimet, gjykata në pajtim me nenin 452 dhe 453 të LPK-së, e detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompenzoj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për përpilimin e padisë në shumë prej 156.00-€, për përpilimin e parashtrësës për precizim në shumë prej 156.00-€, për 1 (një) seanca gjyqësore të përfaqësuar nga i autorizuari e palës paditëse shumë nga 202.20-€, si dhe në emër të taksës gjyqësore për padi për secilën paditëse veç e veç nga 40-€ (pasi paditëset janë bashkëndrygjyqëse të thjesht), apo shumën e përgjithshme prej 594.20-€, shpenzime këto që kanë qenë të nevojshme për përfundimin e këtij kontesti për çka është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të dispozitave të lartcekura si dhe nenit 136 të LMD-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA LIPJAN
C.nr.406/21 me dt.11.06.2024

GJYQTARI,
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtijë aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësajë gjykate.

Numri i lëndës: 2021:111005
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05857813